REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:250640
Datë: 15.02.2024
Numri i dokumentit: 05336545

PPP.nr. 124/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen përmbarimore të kreditorit, International M..... S.....s of Kosova Shpk, me numër identifikues ..... rr "....." p.nr. me seli në Prizren, kundër debitorit A.K., nga Prizreni, rr "Ylli I Dritës" , nr.21, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.296/2023 të datës 07.09.2023, të Përmbaruesit Privat Enis Hoxha nga Prizreni jashtë seancës, me datë 16.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M I.

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit A.K., nga Prizreni, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.296/2023 të datës 07.09.2023, të Përmbaruesit Privat Enis Hoxha nga Prizreni, dhe i njëjti urdhër për përmbarim, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.296/2023 të datës 07.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm faturës me NR:PZ-..... të datës 14.09.2021, duke urdhëruar debitorin që nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 491,15 €, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë e tij bankare në të gjitha bankat komerciale të Kosovës dhe bartjes së shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit dhe më pastaj tek nga kjo llogari të bëhet transferi në llogari të kreditorit, si dhe sekuestrimit, të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin për përmbarim, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të

2023:250641

gjendjes faktike, me tej ka theksuar se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm dhe të faturës me nr. PZ-442 e datës 14.09.2021, siç parashihet nga neni 29 të LPP-së, debitorit i është përcjellë edhe fatura e kreditorit, dhe lartësia e shumës nga propozimi për përmbarim në lartësi prej 491.15 euro, për të cilën është lëshuar urdhri nuk përputhet me lartësinë e shumës së faturës, për të cilën thuhet se ka shërbyer si titull përmbarues, ka propozuar që të pranohet prapësimi i debitorit të pezullohet ekzekutimi i caktuar me urdhrin për përmbarim, të abrogohen të gjitha veprimet procedurale dhe të hedhet poshtë propozimi për përmbarim.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejmë: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *"Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, paragrafi 3 i nenit 29 të LPP-së, përcakton se *"Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar."* Në anën tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së thuhet se *"Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".* Gjykata, pas shqyrtimit të shkresa të lëndës, vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën PZ-442 e datës 14.09.2021, e cila përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë përcaktuar shërbimet me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Në anën tjetër, gjykata gjen se e njëjta faturë i është dorëzuar debitorit, i cili të njëjtën e ka pranuar duke e nënshkruar, dhe rrjedhimisht është informuar me detyrimin që buron nga kjo faturë.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në copje të vërtetuar nga organi kompetent.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim i cili e ka theksuar se lartësia e shumës nga propozimi për përmbarim nuk përputhet me lartësinë e shumës në faturën e sipërshënuar për të cilën thuhet se ka shërbyer si titull përmbarues, mirëpo një

pretendim të tillë e gjen si të pabazuar, ngase sipas kësaj fature ka mbetur pa u përmbushur shuma 4911.15 euro, dhe është pacaktuar edhe afati për pagesë prej 15 ditëve.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo të njëjtat i gjen si të pabazuara, ngase debitori nuk ka ofruar prova për të mbështetur një pretendim të tillë në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, me të cilin parashihet se: *"Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet."*

Gjykata rikujton se në këtë procedurë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e rrethanave tjera, me përjashtim të vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së tij.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.124/2023 datë 16.02.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.